

Datë 26/02/2022

## KALLZIM PENAL

- KALLZUES:** **Dritan Shakohoxha**, në cilësinë e kandidatit për President të Federatës Shqiptare të Futbollit
- ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale të “*Pengime per ekzekutimin e vendimit të gjykatës*”, “*Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës*” dhe “*Shpërdorim detyre*”, parashikuar nga neni 320, 321 dhe 248 i Kodit Penal.
- KUNDËR:** **Z. Aldi Topçiu**, me detyre Drejtor i Departamentit Juridik i Federatës Shqiptare të Futbollit.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 280, 283 të K.Pr.Penale dhe neni 248, 320 dhe 321 i Kodit Penal.
- DREJTUAR:** Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane.  
Drejtorisë Vendore së Policisë së Shtetit Tiranë.
- PËR DIJENI:** Prokurorisë së Përgjithshme.

*I nderuar Z. Prokuror!*

Bazuar ne nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale parashtrojmë këtë kallëzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

### RRETHANAT E FAKTEVE

Kallëzimi mbështetet në veprimet e kundraligjshme të ndërmarra nga shtetasi Aldi Topçiu, me detyre Drejtor i Departamentit Juridik i FSHF-së, në procedurat e ndjekura për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit e planifikuar për t'u zhvilluar me datë 2 Mars 2022. Në vijim Ju parashtrojmë në mënyrë përmbledhëse rrethanat e faktit e vërtetuar me prova mbështetëse, konkretisht:

Rezulton se me datë 2 Mars 2022 ka qënë planifikuar të zhvillohej mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Federatës Shqiptare të Futbollit, për zgjedhjen e

Presidentit të FSHF-së. Në kushtet kur janë konstatuar shkelje të rënda të Statutit dhe të Rregullores së Përgjithshme të Federatës Shqiptare të Futbollit, përsa i përket procedurave të përzgjedhjes së delegatëve nga Shoqatat Rajonale të Futbollit, anëtare në Asamblene e Përgjithshme, rezulton se Akademia Luftëtari (organizatë jo-fitimprurëse), në cilësinë e anëtarit të drejtpërdrejtë të Shoqatës Rajonale të Futbollit Gjirokastër, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesë për sigurim padie, duke kërkuar pezullimin e efekteve juridike të vendimit Nr. 1, datë 10.01.2022 të Komisionit të Verifikimit të FSHF-së, si dhe cdo veprimi apo akti tjetër të dalë në zbatim të këtij vendimi që ka për synim realizimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, të datës 2 Mars 2022.

**Rezultoni se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 274 Rregj. Themeltar, datë 17.02.2022, ka vendosur:**

*Pranimin e kërkesës. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur:*

*1. Pezullimin e efekteve juridike të vendimit Nr. 1, datë 10.01.2022 të Komisionit të Verifikimit të FSHF-së, si dhe cdo veprimi apo akti tjetër të dalë në zbatim të këtij vendimi që ka për synim realizimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, të datës 02.03.2022, deri në zgjidhjen e konfliktit me një vendim gjyqësor të formës së prerë.*

*2. Pezullimin e efekteve juridike të vendimit të datës 21.01.2022 të Komitetit Ekzekutiv të FSHF-së, si dhe cdo veprimi apo akti tjetër të dalë në zbatim të këtij vendimi që ka për synim realizimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, të datës 02.03.2022, deri në zgjidhjen e konfliktit me një vendim gjyqësor të formës së prerë.*

*3. Pezullimin e veprimitarisë së Komisionit të Verifikimit të FSHE-së, në ushtrimin e kompetencave të tij statutore për organizimin, mbikqyrjen dhe drejtimin e Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së, deri në zgjidhjen e konfliktit me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

*Kundër këtij vendimi lejohet ankim i vecantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

*U shpall në Tiranë me datë 17.02.2022.*

Në seancën gjyqësore të datës 17.02.2022, rezultoi se Federata Shqiptare e Futbollit në cilësinë e personit të tretë është përfaqësuar në gjykim nga përfaqësuesi ligjor dhe nga personi i autorizuar z. Aldi Topçiu, me detyrë Drejtor i Departamentit Juridik pranë FSHF-së. Ndodhur para këtij fakti, FSHF-ja ka marrë dijeni në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me vendimin gjyqësor të sipërcituar, pasi përfaqësuesit e FSHF-së kanë marrë pjesë në seancën gjyqësore të shqyrtimit të kërkesës për sigurim padie, si dhe kanë marrë pjesë në seancën e shpalljes së vendimit gjyqësor.

Në kundërshtim me vendimin gjyqësor të sipërcituar, rezultoi se me shkresën Nr. 108 Prot, datë 21.02.2022, dërguar nga FSHF-ja, kallzuesi në cilësinë e kandidatit për

President të FSHF-së, është informuar në lidhje me vijimin e procedurave të zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, të datës 02.03.2022. Konkretisht nëpërmjet shkresës së sipërcituar është vënë në dispozicion lista e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të FSHF-së dhe delegatët e tyre, pjesmarrës në mbledhje.

Bazuar në strukturën organizative të FSHF-së, konstatohet se Drejtori i Departamentit Juridik pranë FSHF-së, është përgjegjës për ndjekjen e procedurave ligjore që lidhen me organizimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, i cili aktualisht vijon të ndër marrë veprime të kundraligjshme në shkelje flagrante me vendimin Nr. 274 Rregj. Themeltar, datë 17.02.2022, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku është vendosur pezullimi i plotë i procesit zgjedhor për zgjedhjen e Presidentit të FSHF-së, dëri në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë që lidhet me paditë gjyqësore të depozituara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pasi janë konstatuar një sërë shkeljesh ligjore nga strukturat pranë FSHF-së, si dhe janë konstatuar shkelje në mbledhjet e zhvilluara nga Shoqatat Rajonale të Futbollit, në lidhje me përzgjedhjen e delegatëve pjesmarrës në Asamblenë e Përgjithshme të FSHF-së.

Pavarësisht urdhërimeve të vendimit gjyqësor të sipërcituar, rezulton se Drejtori i Departamentit Juridik pranë FSHF-së, vijon procedurat për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, duke moszbatuar vendimin gjyqësor. Madje duke bërë edhe deklarata publike, sikurse është shprehur në emisionin "Procesi Sportiv", me datë 21 Shkurt 2022 (<https://youtu.be/DISFh23x4zë>-Gjykata pezullon zgjedhjet, FSHF merr vendimin zyrtar - Procesi Sportiv, 21 Shkurt 2022, 11;30).

Në këto deklarata shtetasi Aldi Topçiu, me detyr Drejtor i Departamentit Juridik pranë FSHF-së është shprehur ndër të tjera se:

*Nuk e njohim vendimin gjyqësor, pasi është nul;  
Kërkesa është bërë nga një subjekt jo anëtar i FSHF-së, i mungon legjitimiteti aktiv;  
Vendimi është dhënë nga një gjykatë jo-kompetente, pasi nuk është kompetenc e gjykatës civile të shqyrtojë çështje të natyrës sportive të organizatave sportive;  
Ligji për sportin parashikon organet e drejtësisë sportive në nivel federal, duke përjashtuar mundësin që organizatat sportive t'i drejtohen gjykatës kjo sepse FSHF-së këtë procedurë ia imponon Statuti i UEFA-s dhe FIFA-s si dhe vetë Statusi i FSHF-së....*

Bazuar në këto deklarata publike, të konkretizuara në veprime të drejtpërdrejta të ndërmarrë nga Drejtori i Departamentit Juridik pranë FSHF-së, i cili në kundërshtim me ligjin vijon procedurat për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të

Zakonshme Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Futbollit, duke moszbatuar vendimin gjyqësor.

*Në nenin 210 të Kodit Procedurës Civile, parashikohet se:*

*Ankimi kundër vendimit që lejon masën e sigurimit, nuk pezullon ekzekutimin e tij.*

*Ankimi kundër vendimit me të cilin zëvendësohet ose hiqet masa e sigurimit, pezullon ekzekutimin e tij.*

Bazuar në parashikimet ligjore të nenit 210 të Kodit të Procedurës Civile, konstatohet se vendimi gjyqësor Nr. 274 Rregj. Themeltar, datë 17.02.2022, i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për “sigurim padie” është menjëherë i ekzekutueshëm dhe ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

Ndodhur para këtij fakti, kërkojmë marrjen e masave të menjëhershme dhe ndjekjen penale të shtetasit Aldi Topçiu, me detyrë Drejtor i Departamentit Juridik pranë FSHF-së, i cili vijon të ndërmarrë veprime të kundraligjshme në shkelje të urdhërimeve të vendimit Nr. 274 Rregj. Themeltar, datë 17.02.2022, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe duke ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta me qëllim pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor përkatës, ku është vendosur pezullimi i plotë i procesit zgjedhor për zgjedhjen e Presidentit të FSHF-së, deri në zgjidhjen e ceshtjes me vendim gjyqësor të formës së prerë. Shkeljet e realizuara nga shtetasi Aldi Topçiu janë bërë me një qëllim të vetëm, ndikimin apo paracaktimin e rezultatit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme Zgjedhore, duke favorizuar drejtuesin aktual të FSHF-së.

## **LIGJI I APLIKUESHËM**

Kodi i Procedures Penale, ne nenet e tij 280 dhe 283 parashikon se:

*Neni 280*

### ***Marrja dijani për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.....*

*Neni 283*

*Çdo person që ka marrë dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.....*

1. Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 320 parashikon se:

*Fshehja, tjetërsimi, konsumimi, dëmtimi apo shkatërrimi i sendeve për të cilat është marrë një vendim prej gjykatës, ose kryerja e veprimeve të tjera të bëra me qëllim që të mos ekzekutohet ose të pengohet ekzekutimi i vendimit gjyqësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.*



**Objekti i kesaj vepre penale** jane mardheniet juridike te vendosura për të siguruar veprimtarine e rregullt të organeve gjyqësore të cilat pengohen ne zbatimin e vendimeve gjyqësore, te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

**Nga ana objektive**, vepra penale kryhet me veprime aktive të kundraligjshme në forma të ndryshme, duke synuar pengimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

**Subjekt i vepres penale**, eshte cdo person qe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem.

**Nga ana subjektive**, vepra penale kryhet me dashje direkte, me qëllim për të penguar ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

**2. Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 321 parashikon se:**

*Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.*

*Kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes të dhëna prej saj, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.*

**Objekti i kesaj vepre penale** jane mardheniet juridike te vendosura me ligj për të siguruar zbatimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me detyrimet e lindura nga dënimet plotësuese të saj, te mbrojtura posacerisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

**Nga ana objektive**, vepra penale kryhet me veprime aktive të kundraligjshme për të kundërshtuar vendimin e gjykatës në lidhje me detyrimet e nga dënimet plotësuese të saj, të tilla vendime si sigurim padie....

**Subjekt i vepres penale**, eshte cdo person qe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem.

**Nga ana subjektive**, vepra penale kryhet me dashje direkte.

**3. Nga ana tjetër Kodi Penal në nenin 248, parashikon se:**

*Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.*



Që të jemi përpara rastit të konsumimit të një vepre penale, duhen analizuar këto elemente të figurës së veprës penale: **objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive**. Që të konkludohet se të një subjekt ka konsumuar veprën penale “Shperdorimi i detyres” duhet që të evidentohet pikë së pari ekzistenca e të gjithë elementëve të kësaj figure vepre penale, në veprimet e tij. Ashtu siç trajtohen në teorinë e së drejtës penale materiale, elementët e veprës penale janë katër, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive, të cilët duhet të bashkëekzistojnë njëkohësisht në mënyrë që një person të merret në përgjegjësi penale.

*Referuar nenit 248 të K. Penal, ligjvënasi ka parashikuar mbrojtje të posaçme për marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti me ligj apo me akte nenligjore për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve ose shtetit; cenimi i të cilave pasqjell përgjegjësi penale. Nga interpretimi i dispozitës së mesipërme arrijme në përfundimin se legjislatori, marrëdhëniet që kanë të bëjnë me përmbushjen e rregullt zbatimit të ligjeve, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, i ka cilesuar si marrëdhënie juridike të rëndësishme, të cilat mbrohen posaçërisht nga legjislatiioni penal.*

1. **Objekt i veprës penale**, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, janë mbrojtja e marrëdhënieve juridike të parashikuara me ligj ose në aktet nenligjore për të siguruar veprimtarinë normale të aparatit shtetëror, si dhe mbrojtjen dhe interesat e ligjshme të shtetasve ose të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislatiioni penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

2. **Nga ana objektive**, krimi i shperdorimit të detyres kryhet me veprime aktive të kundraligjshme ose moskryerjen e veprimeve që përben mospërmbushje të rregullt të detyres. **Per krimin e shperdorimit të detyres është element i domosdoshëm i anes objektive është konstatimi i lidhjes shkakesore të drejteperdrejte midis veprimit dhe mosveprimit të kundraligjshëm, mospërmbushje e rregullt e detyres dhe demtimit të interesave të ligjshme të shtetit, shtetasve dhe të personave të tjere juridik.**

Duke ju referuar interpretimit literal të dispozitës dhe praktikës gjyqësore, elementet objektive të kësaj vepre penale janë:

- a) Kryerja ose moskryerja e veprimeve në kundërshtim me ligjin,
- b) veprimet ose mosveprimet përbejnë mospërmbushje të rregullt të detyre,
- c) veprimet ose mosveprimet kryhen nga një person që ushtron funksione publike,
- d) veprimet ose mosveprimet i kanë sjelle personit ose personave të tjere përfitime materiale ose jomateriale ose kanë demtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve dhe të personave juridike,



3. **Subjekt i kesaj vepre penale**, mund te jete subjekt i posacem, cdo punonjes i ngarkuar me funksion publik. Referuar ligjit te sportit, sporti ne Republiken e Shqiperise eshte nje veprimtari me interes publik ne Republiken e Shqiperise dhe shteti e ka deleguar kete funksion publik tek Federatat Sportive (neni 7 dhe neni 17 i ligjit nr. 79/2017 “Per Sportin ne Republiken e Shqiperise”).

4. **Nga ana subjektive**, vepra penale e shpërdorimit te detyrës kryhet kurdoherë me dashje te drejtpërdrejte ose te tërthortë ndaj veprimeve ose mosveprimeve dhe me pakujdesi ndaj pasojave te ardhura.

Për sa parashtrua si më sipër, vërtetohet qartësisht se me veprimet e ndërmarra nga shtetasi Aldi Topçiu, me detyrë Drejtor i Departamentit Juridik pranë FSHF-së, janë konsumuar elementët e figurave të veprave penale të sipërcituara dhe ky shtetas duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale. Këtij kallëzimi do i bashkëngjisim edhe provat mbështetëse te cilat do te vërtetojnë pretendimet e bazuara, ne cilësinë e palës kallëzuese.

**Për sa me sipër, i kërkoj Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane, regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Pengime per ekzekutimin e vendimit të gjykatës”, “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” dhe “Shpërdorim detyre”, “parashikuar nga neni 320, 321 dhe 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit Aldi Topçiu, me detyrë Drejtor i Departamentit Juridik pranë FSHF-së.**

Kallzues

Dritan Shakohoxha

